

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29, DATË 30.03.2023, ‘PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT’, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, të ndryshuar” është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe nenin 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Vendosja e rregullit antishmangie në ligjin e ri nr. 29/2023 *“Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*, synonte të adresonte praktikën e regjistrimit fiktiv si persona të vetëpunësuar, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore që lindin nga marrëdhëniet e punësimit. Megjithatë, gjatë zbatimit në praktikë të këtij rregulli janë vërejtur ankesa nga personat fizikë që ushtrojnë aktivitete të mirëfilltë biznesi, pavarësisht përqendrimit të të ardhurave te një apo dy klientë.

Për këtë arsye, me këtë projektligj synohet të saktësohet kuadri ligjor përmes vendosjes së një deklarate vetëdeklarative të qartë që ndihmojnë në dallimin ndërmjet të vetëpunësimit fiktiv dhe aktivitetit të ligjshëm ekonomik, duke ruajtur efektivitetin e masës antishmangie, por njëkohësisht duke shmangur penalizimin e padrejtë të tatimpaguesve që operojnë ndershmërisht në treg.

Nëpërmjet këtij projektligji, ky vetëdeklarim para drejtorisë tatimore rajonale u lejon personave fizikë që, edhe në rastet kur të ardhurat e tyre burojnë: 80 për qind ose më shumë e të ardhurave të fituara merren direkt ose indirekt nga një klient i vetëm; ose 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merren nga më pak se 3 klientë, personit fizik i ofrohet mundësia e deklarimit me qëllim vërtetimin nëse këto të ardhura burojnë vërtet nga marrëdhëniet e biznesit, apo janë të ardhura të cilat në kushte normale do të buronin nga marrëdhëniet e punësimit, por me qëllim shmangien tatimore dhe uljen e detyrimeve tatimore punonjësi ka dalë nga listëpagesa dhe është regjistruar si biznes.

Në funksion të krijimit të një sistemi tatimor sa më të drejtë, me anë të këtij projektligji parashikohet përcaktimi i deklaratës se statusit të të vetëpunësuarit ku listohen kritere shtesë, që pavarësisht nëse personi fizik mund të ketë 80% të të ardhurave nga një klient i vetëm, apo 90% nga dy klientë, por në të njëjtën kohë personi fizik ushtron një marrëdhënie të mirfilltë biznesi, atëherë personi fizik të mos penalizohet nga ky rregull antishmangie, por të bëhen vlerësime të mëtejshme lidhur me subjektet të cilat janë realisht shmangës tatimor.

Kriteret që parashikohen në deklaratë lidhen kryesisht me: llojin e shërbimit dhe natyrën e marrëdhënies së punës; sjelljen e të vetëpunësuarit në ambientin e punës; kontrollin mbi produktin e punës dhe faktorët e gjenerimit të tij, të cilat do të vetëdeklarohen nga i vetëpunësuari në Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit.

Gjithashtu, projektligji synon të forcojë rolin e administratës tatimore, duke parashikuar që në rastet kur gjatë verifikimeve apo kontrolleve konstatohet se individ i ofron shërbime në kushte të ngjashme me punëmarrësit, të ardhurat e tij të trajtohen si të ardhura nga punësimi. Këto ndryshime synojnë të krijojnë një ekuilibër ndërmjet mbrojtjes së personave fizikë që ushtrojnë realisht një aktivitet biznesi dhe forcimit të kontrollit kundër shmangies tatimore, duke garantuar trajtim të drejtë dhe të barabartë tatimor.

Ndërkohë, në vijim të përpjekjeve për krijimin e një kuadri tatimor nxitës në fushën e sportit, artit dhe sponsorizimeve, projektligji parashikon gjithashtu shtimin e disa lehtësive fiskale, të cilat kanë për qëllim nxitjen e sponsorizimeve në këto fusha, si dhe krijimin e kushteve stimuluese për artistët e huaj që zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, propozohet:

- ❑ Zgjerimi i kategorisë së subjekteve që përfitojnë nga njohja si shpenzim i zbritshëm në masën sa trefishi i shumës së sponsorizuar, ku shuma e sponsorizuar njihet deri në nivelin 5% të fitimit para tatimit. Kategoritë që do të përfshihen, përveç ekipeve sportive, do të përfshijnë edhe federatat sportive, si dhe sportistët që kanë fituar tituj për meritë në sport;
- ❑ Për përfituesin e sponsorizimit, propozohet që të ardhurat nga sponsorizimi të njihen si të ardhura të përjashtuara nga tatimi;

- ☐ Me qëllim nxitjen e tërheqjes së artistëve të huaj në vend, propozohet përjashtimi nga rezidenca tatimore për një periudhë prej 24 muajsh për artistët që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë.

Këto ndryshime synojnë të krijojnë një ambient më të favorshëm për zhvillimin e sportit dhe artit në Shqipëri, të rrisin bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve sportive e kulturore, si dhe të kontribuojnë në promovimin ndërkombëtar të vendit përmes veprimtarive artistike dhe sportive.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Me miratimin e ligjit të ri nr. 29/2023 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, u miratua dhe një rregull antishmangie i cili parashikon se do të konsiderohen të ardhura nga punësimi të ardhurat e fituara nga një individ i vetëpunësuar nëse:

- ☐ 80 për qind ose më shumë e të ardhurave të fituara merren direkt ose indirekt nga një klient i vetëm; ose
- ☐ 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merren nga më pak se 3 klientë.
- ☐ Ndërkohë nga ky rregull janë përjashtuar vetëm individët e vetëpunësuar, të cilët ofrojnë shërbime vetëm për personat jorezidentë në Republikën e Shqipërisë apo vetëm për entitete që nuk kanë një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

Vendosja e këtij rregulli antishmangie kishte për qëllim adresimin e problematikës së evidentuar gjatë viteve të fundit, ku individët kalojnë nga statusi i të punësuarve në atë të vetëpunësuarve me qëllim shmangien e tatimit. Konkretisht, gjatë prezantimit të këtij rregulli antishmangie është sqaruar se:

- a. Prezantimi i skemës favorizuese tatimore, ku në vitin 2016 u vendos 0% tatim i thjeshtuar mbi fitimin për bizneset me qarkullim deri në 5 milionë lekë, dhe me pas në vitin 2021, norma 0% e tatimit mbi fitimin u vendos për

të gjitha bizneset me qarkullim deri në 14 milionë lekë, ndikoi në deformimin e strukturës së organizimit të biznesit, ku konkretisht janë vërejtur fenomene të tilla si:

- i. Të punësuarit që kalojnë nga tatimi mbi pagën 13% dhe 23%, në tatimin mbi biznesin me normë 0%, duke u regjistruar si të vetëpunësuar, në vend që të jenë në listëpagesë;
 - ii. Aksioneret, administratorët apo punonjës të caktuar, për të shmangur tatimin mbi dividendin prej 8%, pajisen me NIPT si person fizik dhe i “ofrojnë” shërbime kompanisë që zotërojnë direkt apo indirekt, duke rritur fiktivisht shpenzimet, ulur fitimin e tatueshem, si dhe dividendin për t’u shpërndarë.
- b. Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës 2018-2023 numri i personave fizikë që ofrojnë shërbime profesionale është rritur me mbi 10 mijë, ose me mbi 53%. Në vitin 2018, kanë operuar rreth 18,700 biznese në këtë fushë, ndërkohë që me të dhënat e përditësuara sipas balanceve të fundit të vitit 2023, ky numër ka arritur mbi 29,000 biznese. Kjo shifër tejkalon rritjen e pritshme si rezultat i rritjes ekonomike apo rritjes së përgjithshme të bizneseve të regjistruara.

Ndërkohë, pas hyrjes në fuqi të këtij rregulli antishmangie më 1 Janar 2024, nga zbatimi në praktikë dhe kërkesat e subjekteve, është vënë re se jo të gjitha subjektet të cilat preken nga ky rregull antishmangie, kryejnë veprimtari punësimi, ka edhe subjekte të cilat janë të bazuara në marrëdhënie të mirëfillta biznesore, por në varësi të ecurisë së biznesit ndodh që të përfshihen në skemën e vlerësimit të rregullit antishmangie.

Konkretisht, bazuar në të dhënat e administratës tatimore, numri i bizneseve që mund të preken nga ky rregull është rreth 6 mijë subjekte, nga të cilat mbi 1 mijë subjekte janë subjekte të cilat janë regjistruar dhe kanë funksionuar para vitit 2016, vit në të cilin u prezantua dhe norma tatimore 0% për subjektet me qarkullim deri në 5 milionë lekë. Pra, rreth 19% e subjekte që u përfshinë në këtë skemë, janë subjekte që kanë ekzistuar para se të krijoheshin lehtësitë tatimore për subjektet e vogla, lehtësi të cilat më pas ndikuan në erozionin e bazës tatimore të të punësuarve. Pjesa më e madhe e këtyre subjekteve vlerësohet se janë persona fizik të cilët ushtrojnë një veprimtari të mirëfilltë biznesore.

Përsa më lart, dhe me qëllim përmirësimin e sistemit tatimor, duke synuar një sistem të drejtë, të barabartë dhe konkurrencë të ndershme në treg për të gjithë tatimpaguesit, propozohet projektligji *“Për disa shtesa në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, të ndryshuar”*, si një ndërhyrje e nevojshme në legjislacionin tatimor për të adresuar problematikën e ndarjes sa

më të drejtë ndërmjet personave fizikë, veprimtaria e të cilëve është një marrëdhënie e mirëfilltë biznesore, kundërjet personave fizikë që e përdorin si mekanizëm për shmangie tatimore.

Me anë të këtij projektligji përcaktohen me anë të deklaratës së statusit të vetëpunësuarit, kritere të qarta për dallimin mes të ardhurave nga biznesi dhe atyre nga marrëdhëniet e punësimit, duke mbështetur vetëdeklarimin e individëve të vetëpunësuar dhe duke forcuar rolin e administratës tatimore në verifikimin e këtyre të dhënave. Kjo ndërhyrje garanton një trajtim më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë subjektet, duke respektuar veprimtarinë ekonomike dhe vlerësuar marrëdhëniet reale të punës.

Kjo rregullore do të përmirësojë transparencën, do të rrisë përputhshmërinë me detyrimet tatimore dhe do të forcojë besimin në sistemin fiskal, duke kontribuar në një mjedis më të qëndrueshëm ekonomik dhe social, dhe duke përqendruar masat antishmangie ndaj atyre që kryejnë praktika të dëmshme tatimore. Kriteret që parashikohet të vetëdeklarohen nga i vetëpunësuari në Deklaratën e Statusit të të Vetëpunësuarit lidhen kryesisht me: llojin e shërbimit dhe natyrën e marrëdhënies së punës; sjelljen e të vetëpunësuarit në ambientin e punës; kontrollin mbi produktin e punës dhe faktorët e gjenerimit të tij, etj.

Gjithashtu, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për krijimin e një sistemi tatimor konkurrues dhe nxitës për zhvillimin ekonomik, projektligji propozon edhe shtimin e disa lehtësive fiskale në fushën e sportit, artit dhe sponsorizimeve. Këto ndryshime kanë për qëllim stimulimin e investimeve private në sport e kulturë, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si dhe tërheqjen e artistëve të huaj për zhvillimin e veprimtarive artistike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Konkretisht lehtësitë e propozuara janë si në vijim:

- ❑ Zgjerimi i kategorisë së subjekteve që përfitojnë nga njohja si shpenzim i zbritshëm për sponsorizime

Në legjislacionin aktual, sponsorizimet në sport njihen si shpenzime të zbritshme vetëm për ekipet sportive, deri në nivelin 5% të fitimit para tatimit. Me ndryshimin e propozuar, parashikohet që kjo kategori të zgjerohet duke përfshirë edhe federatat sportive dhe sportistët që kanë fituar tituj për meritë, me qëllim rritjen e mbështetjes financiare për sportin elitare dhe zhvillimin e infrastrukturës sportive. Në këtë mënyrë, bizneset private do të kenë mundësi të njohin si shpenzim të zbritshëm sa trefishi i shumës së sponsorizuar, deri në kufirin 5% të fitimit para tatimit.

Ky incentivim fiskal pritet të ndikojë në forcimin e sportit kombëtar dhe promovimin e vlerave sportive shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

❓ Përrjashtimi nga tatimi i të ardhurave të përfituara nga sponsorizimet

Njohja e të ardhurave nga sponsorizimet si të ardhura të përjashtuara nga tatimi synon të rrisë efektivitetin e këtij instrumenti mbështetës. Në praktikë, tatimi mbi të ardhurat e marra si sponsorizim zvogëlonte ndikimin real të sponsorizimit, duke e bërë më pak tërheqës për përfituesit. Kjo ndërhyrje ligjore siguron që mbështetja financiare të shkojë plotësisht në funksion të qëllimit për të cilin jepet sponsorizimi, pra zhvillimi i veprimtarive sportive dhe artistike, pa barrë tatimore për përfituesit.

❓ Përrjashtimi nga rezidenca tatimore për artistët e huaj për një periudhë 24-mujore

Një tjetër ndërhyrje e rëndësishme ka të bëjë me krijimin e kushteve stimuluese për tërheqjen e artistëve të huaj. Në këtë drejtim, propozohet që artistët që nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë të mos konsiderohen rezidentë tatimorë në Shqipëri për një periudhë prej 24 muajsh, pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre për veprimtari artistike. Ky përjashtim parashikohet të kontribuojë në rritjen e interesit për organizimin e ngjarjeve kulturore, koncerteve dhe prodhimeve artistike në territorin shqiptar. Pritet të krijohet një efekt pozitiv në turizmin kulturor, promovimin e imazhit të vendit dhe zhvillimin e industrive krijuese.

Këto masa synojnë të krijojnë një ambient tatimor të favorshëm dhe të qëndrueshëm, që mbështet zhvillimin e talenteve, rritjen e vlerës së shtuar në ekonomi dhe përmirësimin e mirëqenies shoqërore përmes nxitjes së sportit dhe kulturës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është mbështetur në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVË).

Projektligji *“Për disa shtesa në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, të ndryshuar”*, nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis communautaire).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT.

Projektligji përbëhet nga 6 nene:

Në nenin 1 parashikohet përjashtimi nga rezidenca tatimore për një periudhë 24 mujore të artistëve të huaj të cilat nuk janë shtetas në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 2 parashikohet përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale i të ardhurave nga sponsorizimi sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 50, pika 1, shkronja p), e ligjit.

Në nenin 3 parashikohet se rregulli i shkronjës ç, të pikës 1, të nenit 12, nuk zbatohet nëse individ i vetëpunësuar, pavarësisht të ardhurave të përfituara sipas përcaktimeve të shkronjës ç), pika i, ii, deklaron në Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit, pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar. Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit është sipas modelit në aneksin nr. 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore nëse individ i vetëpunësuar është në kushtet e ushtrimit të një aktiviteti biznesor dhe jo në një situatë të shmangies tatimore.

Në nenin 4 parashikohet përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës i të ardhurave nga sponsorizimi sipas kufizimeve të parashikuara në nenin 50, pika 1, shkronja p), e ligjit.

Në nenin 5 parashikohet se entitetet përfitojnë njohjen e zbritjeve sipas nënparagrafit ii, shkronja p), pika 1 e nenit 50 të ligjit, edhe për sponsorizimet në veprimtaritë e federatave sportive dhe sportistët të cilët kanë fituar tutuj për meritë në sport.

Në nenin 6 parashikohet hyrja në fuqi e cila është 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohet Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projektligji nuk mund të parashikohen në këtë moment.

MINISTRI
Petrit Malaj